

BOTIME TE BASHKESISE SONE

Idriz Lamaj: "Komiteti Kombëtar 'Shqipëria e Lirë'"

*Ndihmesë e vyer për njohjen
e veprimtarisë politike të emigracionit*

Studiuesi dhe publicisti i mirënjohur në komunitet, z. Idriz Lamaj, njohës i problemeve shqiptare të periudhës së Luftës së Ftohtë, që duke qenë gazetar i "Zërit të Amerikës dhe redaktor gazete dhe duke bashkëpunuar në shtypin e kohës, ka përcjellur përmes shtypit dhe radios kohën dhe ngjarjet, mbas botimit të dy veprave të dr. Rexhep Krasniqit: "Komiteti Shqipëria e Lirë dhe shkrime të tjera" dhe "Kongresi i Berlinit e Verilindja e Shqipërisë, kohët e fundit botoi librin "Komiteti Kombëtar Shqipëria e Lirë - 1949-1956".

"Ky botim-siç thotë autori në hyrjeplotëson zbrazëtinë e dy studimeve serioze të botuara vite më parë, atij të Lordit Nicholas Bethel, 'Betrayed' 1984, në të cilin pasqyrohet veprimtaria luftarake e Komitetit Kombëtar 'Shqipëria e Lirë' dhe nuk thuhet gjë për veprimtarinë politike të Komitetit, dhe librit të Dr. Rexhep Krasniqit, 'Komiteti Shqipëria e Lirë' 1997, në të cilin paraqitet vetëm veprimtaria e Komitetit prej vitit 1956 deri më 1991".

Kjo vepër e hartuar mbi bazën e përvojës vetjake të punës së autorit pranë Komitetit, e ilustruar me një përzgjedhje të kujdesshme të artikujve të gazetës "Shqipëria"-organ i KKSHL -dhe shtypit autoritar amerikan "The New York Times", "The Christian Science Monitor", "World Telegram" dhe informacioneve të radiostacioneve "Zëri i Shqipërisë së Lirë", "Zëri i Amerikës", "Evropa e Lirë", e argumentuar me relacione të KKSHL, me letra të personaliteteve politike, me raporte të pabotuara dhe deri me dëshmi gojore, duke i dhënë dorë autorit të bëjë një shqyrtim kritik të fakteve, ngjarjeve, personaliteteve, në të njëjtën kohë u krijon mundësinë lexuesve të vëmendshëm dhe studiuesve të interesuar të nxjerrin konkluzione të pavarura rreth objektit që shtjellohet. Mbasi bëhet fjalë për gjendjen e Shqipërisë para themelimit të KKSHL dhe për Komitetin "Evropa e Lirë", jepet historiku i krijimit të KKSHL dhe shtjellohet veprimtaria e këtij institucioni.

Themelimi i KKSHL u shpall në Paris, më 26 gusht të vitit 1949, por e ushtroi veprimtarinë e tij në New York. Që në fillim ai punoi për të paraqitur realisht para botës gjendjen e mjerruar të Shqipërisë nën sundimin e përgjakshëm të regjimit komunist dhe për të organizuar përpjekjet për çlirimin e Shqipërisë nga ai regjim antipopullor dhe antikombëtar. Në statutin e tij të botuar më vonë (në v. 1954), thuhet: "Komiteti ka për qëllim të sigurojë independencën dhe integritetin tokësor e kombëtar të Shqipërisë si dhe sovranitetin e shtetit në gjirin e Kombeve të Bashkuara, për t'i siguruar popullit shqiptar zgjedhje të lira dhe për zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Shqipërisë në bazë të parimeve të Kartës së Atlantikut". Dhe më poshtë: "KKSHL është një lëvizje për çlirim dhe jo një qeveri në mërgim". Ky Komitet u themelua nga Mithat Frashëri dhe u drejtua nga Hasan Dosti. Në të bënin pjesë personalitete politike të Ballit Kombëtar dhe të Legalitetit.

KKSHL e zhvilloi veprimtarinë e vet nën udhëzimet e Komitetit "Evropa e Lirë", organizëm i krijuar dhe i drejtuar nga personalitete të njohura amerikane dhe figura të shquara politike të Evropës Lindore e Juglindore dhe, më vonë, nën udhëzimet e ACEN-it (The Assembly of Captive

European Nations), që u themelua në v. 1954 dhe punoi për më se 30 vjet, duke i bërë një luftë politike e diplomatike regjimeve komuniste të Evropës Lindore e Juglindore dhe lëvizjes komuniste botërore, në përgjithësi.

Komiteti "Evropa e Lirë" dhe, më vonë, ACEN-i ishin për përfaqësimin në KKSHL të të gjitha grupeve politike të emigracionit shqiptar. Që në vitin 1952, Komiteti "Evropa e Lirë" i deklaroi Hasan Dostit se nuk mund të mbante lidhje politike me një Komitet, ku nuk përfaqësoheshin të gjitha grupet e emigracionit shqiptar në botën e lirë dhe që nuk di të realizojë bashkimin midis grupeve. Dosti, megjithëse që i bindur për një nevojë të tillë, nën tryshninë e Ballit Kombëtar Agrar, (i themeluar fill mbas vdekjes së Mithat Frashërit dhe i drejtuar nga Abaz Ermeni), i cili kërkonte të monopolizonte veprimtarinë politike, arriti ta shtyjë zgjerimin e Komitetit për më se 3 vjet. Së fundi, Dosti, me këmbënguljen e Komitetit "Evropa e Lirë", formoi një komitet të zgjeruar me 39 anëtarë, gjë që, qysh në fillim, krijoi një anarki të plotë, për shkak të fërkimeve dhe grindjeve midis personave me pikëpamje të kundërta politike.

Në vitin 1956, Hasan Dosti dhe i gjithë komiteti shkarkohen nga detyra. Ministria e Jashtme Amerikane dhe ACEN-in sollën nga Australia dr. Rexhep Krasniqin, që krijoi një komitet ku bënin pjesë, përveç përfaqësuesve të Ballit e Legalitetit, edhe përfaqësues të Blokut Kombëtar Independent si dhe figura të njohura të politikës dhe të inteligjencës së emigracionit.

Që në hapat e para të jetës së vet, KKSHL zhvilloi një fushatë të ashpër për të demaskuar demagogjinë e regjimit komunist dhe pasqyroi me vërtetësi gjendjen e mjerruar të popullit shqiptar, terrorin e kuq, vrasjet, burgosjet, internimet, varfërinë, mungesën e lirisë së fjalës dhe të të gjitha të drejtave njerëzore, politikën e jashtme tradhtarake, rusifikimin e kulturës, të arsimit, etj.

Ja çfarë shkruhet lidhur me këtë në gazetën "Shqipëria" (datë 15 shkurt 1954, f.2): "Ministri i Arsimit, Bedri Spahiu deklaroi tekstualisht: 'Këtu e dhjetë vjet më vonë, i tërë populli ynë do të jetë në gjendje të flasë e të shkruajë në gjuhën e madhe të Leninit e të Stalinit; kështu që s'do të kemi nevojë për gjuhën shqipe, që është një gjuhë e varfër, me të cilën s'mund të përkeqësojmë siç duhet veprat e shokëve të mëdhenj të Bashkimit Sovjetik'".

Për të krijuar një ide sa më të plotë të funksionimit dhe veprimtarisë së KKSHL, autori ka botuar aty një bisedë me kapidanin e Mirditës, Ndue Gjormarkajn, i cili ka qenë anëtar i të dy komiteteve, i Komitetit të riorganizuar dhe i Komitetit të drejtuar nga Rexhep Krasniqi dhe, njëkohësisht, një nga figurat kryesore të Blokut Independent. Eshhtë botuar gjithashtu edhe një raport të Xhafer Devës për pikëpamjet e tij ndaj KKSHL dhe partive politike në mërgim. Të dy këto materiale paraqesin një interes të veçantë për të kuptuar mosmarrëveshjet në gjirin e emigracionit politik shqiptar në botën e lirë.

Në vazhdim, vijmë dy kapitujt: "KKSHL dhe 'Bashkimi i Të Arratisurve Politikë të Shqipërisë' në Jugosllavi" dhe "KKSHL dhe Federata 'V' e Lirë", që vlejnjë për të sqaruar marrëdhëniet e Komitetit me këto dy institucione.

Vijon në faqen 23

Nga "Mos më ik larg" deri në "Infinit"


Shënime për dy vëllime poetike të Gjekë Marinajt

Nga Kolec Traboini

Në dy libra të botuar, njëri në Shqipëri më 1995 dhe tjetri në Teksas më 2000, që më ranë në dorë kohët e fundit, gjeta poetin e vërtetë, poetin që në fillimet e veta në vitin 1990 modestisht kishte botuar një poezi në gazetën "Drita", poezinë "Kuajt" që i dha autorit të ri nga Bajza e Shkodrës sa famë aq dhe travajë.

Ndërkohë që shumë lexues anë e mbanë Shqipërisë e admironin, madje ato 21 vargje i kishin kopjuar e kaluar dorë në dorë, sigurimi i asaj kohe e thërret autorin në Degën e Brendshme në Shkodër për një bisedë informative, çka nënkuptonte rrezikun e arrestimit të tij. I ndodhur përpara dyerve të hapura të burgut të diktaturës, autori preferon arratinë në Jugosllavi.

U tha atëherë se autori iku duke mos lënë kurrfarë gjurmë, e kjo për shumë




Gjekë Marinaj

dashamirës të poezisë krijoi një boshllëk, trishtim e pshtjellim të madh sepse kurrkush nuk e ndjente veten të sigurt e të përjashtuar nga kësajsoj thirrjesh ogurzeza të Sigurimit.

Do të kalonin 5 vjet (kohë e bjerjes së madhe intelektuale për Shqipërinë) dhe në libraritë e vendit do të shfaqej libri "Mos më ik larg", çfarë përbente aktin e kthimit poetik të Gjekë Marinajt tek lexuesit shqiptarë, që nga Teksasi i Amerikës ku ai jetonte e krijonte. E në këtë kthim poetik, poezia e shumënjohur "Kuajt" kishte të drejtën e qytetarisë për të qenë në krye të 52 poezive, që përbente vëllimin e parë poetik të autorit. Le ta përcjellim tek lexuesi për të risjellë emocionet e asaj kohe kur na dukej vetja se ishim më shumë kuaj se njerëz:

Tërë jetën duke vrapuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç' bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim,
Heshtim,
Dëgjojmë,
Hamë atë ç'na japin,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendjehollë.
Kush qe kalë mbreti
Posti qe i lartë,
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë,
Kush qe kalë fshatari
Pat samar me kashtë,
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë.
Por qemë dhe mbetem kuaj para njeriut.



Në vëllimin e parë poetik, të shkruar sa në Shqipëri sa në arratinë kampeve të përqëndrimit në Beograd dhe më pas, më 1992, në tokën e lirë amerikane, në Kaliforni dhe Teksas, spikat ritmi poetik i jetës me vargje lirike si: "Ku po më shpie kaq thellë vetmia ime"- nga poezia. "Sot ndjehem tretur botë",- apo ankthi i pritjes në botën e mërgimtarit:

"Pemët i lëshuan nëpër tokë gjetet...
E zogjtë vrapojnë pas tyre të të gjejnë
me mendimin se janë gjurmët e tua...
Ata ecin dhe lëndinën e mundon
një pritje e gjatë."

(Nga poezia "Vonesa e motrës")

Ndryshe prej vëllimit të parë ku spikatin ndjesi të brishta rinore, pas pesë vjet udhe në shtigjet poetike, Gjekë Marinaj vjen me një zë të formuar e veçanësi në artin poetik. Ai shfaqet si poet i konsoliduar, mjeshtër i vargjeve të cilat përshkohen me një intensitet drite e figuracioni në lëvizje të vazhdueshme, abstragime përtej realitetit, frymëmarrjen që tretet në avujt e tokës, në pëllumbat e Nerudes, llavën e vullkaneve dhe vajzat e Kalifornisë, duke e shfaqur botën e vet poetike herë si gjysmëplanet i përskuqur e herë-herë si luledielli vangogian në një metamorfim të shndritshëm, siç përshkohet drita në fibrat optike. Perceptimi i botës prej ndjesive poetike të autorit të librit "Infinit" është modern dhe shpreh në vetvete zhvillimet marramendëse që ka marrë shoqëria njerëzore, e cila në aparençë të krijon përshtypjen se teknologjia e sofistikuar e ndjenjat e holla janë në kahje të kundërta ekstreme, por në të vërtetë tek poetët me potencial të lartë artistik unisohen. Le ta citojmë sërish poetin Marinaj në vargjet për Van Gogun:

Koha e fëmijëzuar fut këmbët e vockla
në këpucët e tua të ënjtura arti.
Jeta do të soset më vonë
sepse koha ka shtangur para "Lulediellit"
tënd.

(Nga poezia "Jeta do të soset më vonë")

"...Tokësorët dërgojnë astronomë, anije kozmike, Apollo 13...
të zbulojnë jetë në planetet e tjera, e dashur,
pa e kuptuar se diçka magjike për mirë ka ndryshuar
me rritjen tuaj,
pa e ditur se të gjitha planetet janë të vargëzuara
dhe të varura si stolisje ëndërrorë në qafën tënde."

(Nga poezia "Pa e kuptuar-Dusites")

Vijon në faqen 23